

VENDIM
Nr.339, datë 1.6.2004

**PËR SISTEMIMIN ME MJEDISE PUNE TË DISA INSTITUCIONEVE SHTETËRORE DHE
PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES"**
(Ndryshuar me Vkm nr. 602, datë 3.10.2005; Vkm nr. 110, datë 6.3.2024)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja "c" të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. *Shfuqizuar.*
 2. Prona me numër rendor 72, "Sh.a. Elektronika e ushtrisë", në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, në rrugën "Myslym Keta", Tiranë, sipas genplanit nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, dhe t'i kalojë në përgjegjësi administrimi Institutit të Trajnimit të Administratës Publike.
 3. Mjediset, që aktualisht i ka në përdorim Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, në bulevardin "Zogu I", pas rikonstruksionit të mjediseve të shoqërisë anonime "Elektronika e ushtrisë", t'i kalojnë në përgjegjësi administrimi Komitetit Shtetëror për Kultet.
3.1. Mjediset në përgjegjësi administrimi të Komitetit Shtetëror për Kultet janë sipas formularit 1 (një) fletë dhe planimetrive 2 (dy) fletë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.
 4. Ngarkohen Ministri i Shtetit për Koordinimin, Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Integritetit Europian, Drejtori i Përgjithshëm i Radiotelevizionit Shqiptar, kryetari i Komitetit Shtetëror për Kultet dhe Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme të ndjekin procedurat për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Vendimi nr.47, datë 22.1.2004 i Këshillit të Ministrave "Për sistemimin me mjedise të disa institucioneve shtetërore", shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano


(Shtuar me vkm nr. nr. 110, datë 6.3.2024)

1. FORMULAR I PËRDITËSIMIT TË PRONËS

Institucioni Qendror Shtetëror: Komiteti Shtetëror për Kultet

Identifikoi pronën: *Bartula Goga*
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Supervizori: *Shanë Kati*
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: *Klodian Baku*
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., adresa, vula)

Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurisë	Lloji i Pronës	Emërtesa e pasurisë Adresa	Sip e pasurisë (m2)	Nga Sip.		Funksioni për të cilin përdoret pronë pasuria	Institucioni me përgjegjësi administrative/pronësi	Institucioni erdoret i pasurisë Statusi i fundit i përdorimit	Institucioni me VKM	Te dhena të tjera (Shenime të veçanta)
						Truall (m2)	Ndertese (m2)					
1	ZK 8350	Pjesë e pasurisë 6/217	Njësi	Komiteti Shtetëror për Kultet Bulevardi Zogu 1			28.6	Administratë	Komiteti Shtetëror për Kultet	Komiteti Shtetëror për Kultet	VKM 339 Date 1.6.2004	Sipërfaqe prej 23 m2, ndërtim informal
2	ZK 8350	Pjesë e pasurisë 6/217	Njësi	Komiteti Shtetëror për Kultet Bulevardi Zogu 1			105	Administratë	Komiteti Shtetëror për Kultet	Komiteti Shtetëror për Kultet	VKM 339 Date 1.6.2004	



Klodian Baku
KOMITETI SHTETËROR PËR KULTET

